

PROCESVERBAL

Mbledhja e Konstituimit

Sot me datë 09.06.2023, ora 10:00, në sallën e American Corner të pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina” ,u mbajt sot mbledhja e konstituimit të Këshillit Bashkiak Kukës, dalë nga zgjedhjet e 14 Majit 2023, në zbatim të ligjit 139/2015.” Për Vetëqeverisjen vendore “.Rregulloren e funksionimit dhe organizimin të Këshillit Bashkiak si dhe njoftimin përkatës.

Në mbledhje morën pjesë : **Gazmend Hallaci, Albert Muja, Republika Tusha, Arjeta Zela, Astrit Dobrush, Xhem Visha, Albana Bajraktari, Erjon Brati, Rubin Omuri, Blerona Potja, Adelina Shllaku, Sami Mata, Edmond Hallaçi, Ervis Gjana, Bledar Lleshaj, Valion Muja, Arjan Cengu, Astrit Cengu, Aurora Guska, Bajr Bajra, Musë Kastrati, Arif Rexhmati, Gazmend Oruçi, Gëzim Shehu, Teuta Elezaj, Armida Rexhaj, Halim Peca, Lumturije Gjuta, Hume Elezaj, Fasli Gërmizi, Destan Spahiu,**

Mbledhja hapet nga Sekretari i Këshillit Bashkiak, zj. Eridona Ramallari. Në këtë mbledhje do të shpërndahen mandatet për 31 anëtarët e shpallur fitues sipas Vendimit të KQZ (lexohen emrat), do të bëhet shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë si dhe do të zgjidhen përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak Kukës në Këshillin e Qarkut.

Mbledhja drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë, z. Sami Mata, i cili lexon rendin e ditës: zgjedhja e komisionit të mandateve, dhënia e mandateve të anëtarëve të këshillit, zgjedhja e komisionit të votimit, zgjedhja e kryetarit të Këshillit Bashkiak, zgjedhja e zv/kryetarëve të këshillit, shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë, zgjedhja e përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut.

Fillohet me zgjedhjen e komisionit të mandateve. Propozohen për anëtarë të komisionit të mandateve Z. Arjan Cengu, Valion Muja, Destan Spahiu, Republika Tusha (nuk pranon të jetë pjesë e komisionit të mandateve). Nuk ka propozime të tjera. Vendoset miratimi i komisionit të mandateve me 3 anëtarë, si më poshtë: Destan Spahiu, Arjan Cengu, Valion Muja.

Vetë komisioni i mandateve zgjedh z. Destan Spahiu Kryetar, Arjan Cengu Zv/kryetar dhe Valion Muja Sekretar. Komisioni shqyrton materialet dhe vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit emër për emër.

Anëtari i këshillit z. Astrit Cengu i referohet nenit 47 të ligjit 139/2015, lidhur me papajtueshmërinë e mandatit të këshilltarit dhe pyet nëse ndonjë nga këshilltarët është në konflikt me këtë pikë të ligjit.

Z. Destan Spahiu: Nëse kemi lidhje familjare, ju lutem të deklaroni.

Fasli Gërmizi: Fillimisht suksese të gjithë këshilltarëve. Duhet të vlerësoni përbërjen gjinore të komisionit.

Sami Mata: Ju nuk pranuat të propozoni asnjë anëtar komisioni.

Prefekti: Ju e kishit të drejtën dhe mundësinë të bënit propozimet tuaja.

Destan Spahiu lexon nenin 47 të ligjit. Sekretari i Këshillit, zj Eridona Ramallari shpjegon nenin 47 dhe kërkon nga ana e këshilltarëve që të zbatojnë detyrimin ligjor të vetëdeklarimit nëse gjenden në një nga rastet e papajtueshmërisë së funksionit të këshilltarit bashkiak.

Aurora Guska: Shpjegimi nga ana e Eridonës është shumë i saktë.

Sami Mata: Kush ka pretendime mund të bëjë ankim.

Arif Rexhmati: Duhet të jemi shumë korrekt. Ata persona që kanë lidhje familjare duhet ta deklarojnë. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Zj. Albana Bajraktari është motra e zj. Republika Tusha dhe paraqitet para komisionit të mandateve për të dhënë dorëheqjen nga funksioni.

Komisioni tërhiqet për të plotësuar procesverbalin përfundimtar dhe raportin shpjegues. Lexohet raporti i komisionit të mandateve: Morën pjesë në mbledhje 31 anëtarë. Vërtetohet mandate për 30 anëtarë. Nuk vërtetohet mandati për zj. Albana Bajraktari.

Hidhet në votim raporti i komisionit të mandateve. Miratohet me të gjitha votat. Sami Mata lexon formulën e betimit dhe të gjithë anëtarët e këshillit betohen duke nënshkruar formulën.

Vazhdohet me rendin e ditës. Zgjidhet komisioni i votimit. Propozohen: Aurora Guska, Destan Spahiu, Ervis Gjana, Gazmend Hallaçi dhe Adelina Shllaku. Miratohet Komisioni me 5 anëtarë. Ndërkohë që fillon përgatitja e fletëve të votimit, zj. Eridona Ramallari fton të bëhen propozimet për kryetar të Këshillit Bashkiak.

Sami Mata propozon z. Albert Muja. Nuk ka propozime të tjera. Ftohen anëtarët e këshillit për të bërë votimin e fshehtë për kryetarin e këshillit. Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit të votive rezulton se kanë votuar 29 këshilltarë. 1 votë është e pavlefshme. Zgjidhet kryetari i këshillit Albert Muja me 28 vota pro.

Kryetari i ri i Këshillit Bashkiak mban fjalën përshëndetëse dhe fillojnë propozimet për zgjedhjen e zv/kryetarëve të këshillit. Fillimisht këshilli vendos që të ketë 2 zv/kryetarë.

Rubin Omuri propozon Edmond Hallaçin.

Republika Tusha propozon Lumturije Gjutën (nuk pranon).

Arjeta Zela propozon Adelina Shllakun.

Adelina Shllaku largohet nga komisioni i votimit. Ftohen anëtarët e këshillit të propozojnë një anëtar tjetër për komisionin e votimit. Propozohet Xhem Visha dhe miratohet.

Meqenëse për zv/kryetar të këshillit kemi 2 kandidatura për 2 pozicione, vendoset që votimi të bëhet i hapur.

Miratohen me shumicë votash Edmond Hallaçi dhe Adelina Shllaku si zv/kryetarë të këshillit.

Vijohet me rendin e ditës, shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë. Albert Muja lexon vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për vlefshmërinë e mandatit të Kryetarit të Bashkisë. Bëhet betimi i kryetarit të bashkisë i cili mban dhe fjalën përshëndetëse.

Vazhdon mbledhja me pikën e fundit të rendit të ditës, zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut. Këshilli Bashkiak Kukës do të zgjedhë 4 përfaqësues. Propozohen kandidaturat si më poshtë:

Astrit Dobrush

Republika Tusha

Gazmend Oruçi

Astrit Cengu

Arjeta Zela

Rubin Omuri

Komisioni i votimit përgatit materialet dhe ftohen anëtarët e këshillit për të votuar.

Pas mbarimit të procesit të votimit, rezulton:

Astrit Dobrushki - 27 vota

Arjeta Zela _ 21 vota

Republika Tusha- 13 vota

Rubin Omuri – 17 vota

Gazmend Oruçi- 13 vota

Astrit Cengu – 15 vota.

Sipas këtij rezultati, vetëm 3 nga kandidatët kanë marrë më shumë se 16 vota (shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit). Komisioni vendos shpalljen e 3 anëtarëve përfaqësues në Këshillin e Qarkut. Rezultati për përfaqësuesin e 4-ët vendoset të dërgohet për interpretim në organe kompetente.

Shpallet mbyllja e mbledhjes në orën 12:52.

Kukës me 09.06.2023